

L I G J
Nr.8469, datë 31.3.1999

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8169, DATË 21.12.1996 “PËR MIRATIMIN ME
NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.1648, DATË 20.11.1996 “PËR THELLIMIN E
MËTEJSHËM TË PROCESIT TË PRIVATIZIMIT TË BANKAVE TREGTARE ME
KAPITAL TËRËSISHT SHTETËROR””**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8169, datë 21.12.1996 1996 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1648, datë 20.11.1996 “Për thellimin e mëtejshëm të procesit të privatizimit të bankave tregtare me kapital tërësisht shtetëror”” në nenin 4 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Detyrimet e njohura deri tani për kreditë bankare të marra në Bankën Kombëtare Tregtare nga ish-ndërmarrjet shtetërore, para datës 30.6.1992, të konvertohen në bono thesari me terma dhe kushte tregtare. Termat dhe kushtet e bonove të thesarit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 2

Këshilli i Ministrave për vitin 1999 të përdorë fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për të përballuar pagesën e interesave, si dhe të parashikojë në buxhet shumat e nevojshme për përballimin e interesave në vitet në vijim.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2343, datë 6.4.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**